REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 955/20
Data/Datum. 01-12-2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Xhevdet Bajhi ***Eksperti shqyrtues i jashtëm***	**18.11.2020**	**30.11.2020**	Nr. i lëndës: **955/20**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.11.2020, OE "EKO-DDD" (Besim Zejnullahu B.I) –Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: **955/20**, kundër njoftimit për **Vendimit te AK te KK-Pejë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Deratizimi, Dezinsektimi, Dezifektimi në Objektet e Komunës së Pejës"** me nr te prok: **635-20-5894-2-2-1** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - **KK-PEJË (KP).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurëtë hapur**, lloji i kontratës: **sherbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **67,000.00 €.**

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i **OSHP-së**)

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Shpallja e procedurës ne e-prokurim 29.09.2020
Dorëzimi i tenderit: 21.10.2020
Hapja e ofertës : 21.10.2020
Njoftimi Leter standarde:04.11.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK-se: 04.11.2020
Kerkesaper rishqyrtim: 07.11.2020
Pergjigje e AK-së: 13.11.2020
Kriteri i dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me çmim me te lire

Dispozitat e shkelura te AK-së

Neni 1
Neni 6
Neni 7
Neni 28
Neni 56
Neni 59
Neni 69
Neni 72

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

—

Pretendimet ankimore te OE ankues

Në pajtim me dispozitat e nenit 109 të LPP-së, parashtrojmë këtë ankesë kundër vendimit të AK-Komuna Pejë mbi refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim si dhe njoftimit për dhënie të kontratës për OE. "Vetrok" SHPK si OE i papërgjegjshëm lidhur me aktivitetin e prokurimit "Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinsektimi në objektet e Komunës së Pejës", me nr.prokurimi: 635-20-5894-2-2-1.

AK me rastin e rishqyrtimit të kërkesës sonë, nuk ka vepruar konform nenit 108/A të LPP-së, me qëllim të evitimit të gabimeve të rasteve të vlerësimit , ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave, për qudi i njëjti ka konfirmuar shkeljet të cilat janë bërë në fazën e vlerësimit dhe fare nuk kanë dhënë përgjigje në pretendimet tona ankimore se qëndrojnë apo nuk qëndrojnë duke mos dhënë arsye se përse nuk qëndrojnë pretendimet tona ankimore.

Ne nuk pajtohemi me vendimin e AK-Komuna e Pejës pasi qe OE "Vetrok" SHPK është i papërgjegjshëm dhe se i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat e DT me çka AK-Komuna e Pejës me rastin e rishqyrtimit të aktivitetit të prokurimit "Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinsektimi në objektet e Komunës së Pejës", me nr.prokurimi: 635-20-5894-2-2-1 ka bërë:

- Vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, dhe
- Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Se AK-Komuna e Pejës me rastin e vlerësimin dhe rishqyrtimin e kërkesës sonë, ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kjo është evidente sepse të gjitha pretendimet ankimore nuk kanë dhënë asnjë sqarim si dhe kërkesat e caktuara në DT të cilat janë përcaktuar nga vet autoriteti kontraktues nuk i ka marr për bazë gjatë vlerësimit të lëndës.

AK Komuna e Pejës ka përcaktuar buxhetin në vlerë prej 67,000 euro për realizimin e projektit në mënyrë profesionale si dhe ka caktuar kriteret të cilat duhet të plotësohen nga OE-të të cilët ofertojnë, ndërsa në rastin e rivlerësimit po i hudh poshtë të gjitha kriteret e dosjes së tenderit me arsyetimin e nenit 59.4 të LPP-së këto qështje i marr si të kalueshme duke e marr në konsideratë kursimin dhe ruajtjen e parasë publike.

Si mund të konsiderohen se janë të kalueshme përderisa OE "Vetrok" SHPK nuk plotëson kriteret e kërkuara në DT ndërsa sipas sipas LPP-se, neni 59.4.
"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Andaj ne si OE të pakënaqur me vendimin e tyre njoftojmë Panelin shqyrtues dhe ekspertin shqyrtues si më poshtë:

Menjihere pas pranimit të letrës standarde dhe Njoftimit të vendimit për shpërblim me kontratë kemi kërkuar në AK qasje në dokumentacionin e OE së rekomanduar për kontratë pasi kemi pasur dyshimet tona të bazuara që i njëjti është i papërgjegjshëm qe nuk i ka plotësuar kërkesat e kërkuara në DT.

AK Komuna e Pejës me dt.05.11.2020 na ka lejuar që të kemi qasje në dokumentacionin e OE së rekomanduar për kontratë dhe pas kontrollit dyshimet tona u pasi që i njëjti nuk i plotësonte kriteret e kërkuara.

Kriteri i paplotësuar 1
Në dosjen e tenderit te kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:

Kerkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjajëshme në vler prej 100.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.

Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3vitet e fundit.

OE i shpërblyer me kontratë nuk e plotëson këtë kriter pasi që në listën e ofruar dhe dëshmitë mbi projektet e realizuara nuk ka asnjë projekt të ngjashëm me titullin e këtij tenderi: Deratizim, dezinsektim dhe dezinfektim të objekteve. Të gjitha dëshmitë e ofruara janë vetëm nëlëminë e pastrimit. Asnjë projekt nuk ka të realizuar nëderatizim, dezinsektim apo dezinfektim. Nuk është rastësi që për shërbime të DDD duhet të licencohesh fillimisht. Kompania në fjalëështë e licencuar për shërbime të DDD (në gusht 2020), por deri tani nuk ka asnjë dëshmi që ka realizuar ndonjë nga këto shërbime (deratizim, dezinfektim apo dezinsektim).

Kriteri i paplotësuar 2
Në dosjen e tenderit te kapaciteti teknik dhe profesional keni kërkuar:

Kërkesa 3

Kompanija duhet të ketë 1 ekspert me trajnim nderkombetar për kryerjen e pastrimit dhe denzifektimit të hapsirave të ndryshme.

Dëshmia 2
Certifikat që dëshmon mbi kryerien e trajnimit ndërkombetar.

OE i shpërblyer me kontratë ka ofruar një diplomë në gjuhën gjermane të lëshuar në tetor 2012

DerVetronmasterëeistXhevdetLatifi
AlsqualifizierteReinigungs – Fachkraftaus.
Ky dokument nuk i plotëson kriteret e DT për këto arsye:
1.Ne baze te këtij neni 13.4.,

Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.

Dokumenti i ofruar nuk pranohet pasi që i njëjti është në gjuhën gjermane:

2. Nëse përkthehet ky dokument nuk besojmë se i plotëson kërkesat e DT-së pasi i njëjti nuk përmban fare trajnim për dezinfektim, por vetëm për pastrim
3. Ky dokument na bën të dyshojmë pasi që për trajnime lëshohen certifikata, ndërsa në dokument nuk ka shkruar fare certifikatë vetëm ne ballë të këtij dokumenti shënon DIPLOM (duhet të verifikohet nga AK)
4. Çdo certifikate ndërkombëtare posedon numër dhe validitet te cilat mund te verifikohen ne webfaqen e lëshuesit te certifikatës (OE nuk e posedon një të tillë).

Kriteri i paplotësuar 3

Te anexi 1 ne DT – Specifikimet teknike të detyrueshme është kërkuar: Preparati për dezinfektim Micro- quat classic ose ekuivalent (e cila duhet te posedoj një deklaratë nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja, që dëshmon se dezinfektuesi i tillëështë efikas për eliminimin e Covid-19 te OE i shpërblyer me kontratë nuk plotëson këtë kriter pasi që i njëjti nuk ka ofruar një deklaratë të tillë e cila është kërkuar në DT e këtij tenderi (DEKLARAT NGA ECDC, OBSH ose IKSHP-ja QË DESHMON QE DENZIFEKTUESI I TILL ËSHTË EFIKSAS PER ELIMINIMIN E COVID– 19)

OE i shpërblyer me kontratë nuk plotëson këtë kriter pasi i njëjti nuk ka ofruar ndonjë deklaratë të tillë e cila është kërkuar në DT e këtij tenderi (Deklaratë nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja QË DESHMON QE DENZIFEKTUESI I TILL ËSHTË EFIKSAS PER ELIMINIMIN E COVID – 19)

Ne si OE nuk kemi bërë kërkesë tek AK-Komuna e Pejës që të kemi qasje në dokumentacion e kemi bërë përmes e-mailit. Pasi që AK na njofton se nuk mund të dërgoj përmes emailit por duhet patjetër të shkojmë e ti marrim, ne e angazhuam njërin nga punëtorët tanë i cili ishte atë ditë në Pejë për kryerjen e shërbimeve në institucionet e tjera. Në USB që u ka dhënë stafi ynë AK i ka bërë kopjen e dokumentacionit jo vetëm për OE "ECO VETROK" SHPK, sic kemi kërkuar por për gjithë OE e tjerë të këtij tenderi.

Andaj ne si ofertues pasi që ishim duke bërë ankesë për vendimin e AK-Komuna e Pejës me dt.04.11.2020 i kontrolluam dhe dokumentet e ofertuesve tjerë të cilët ishin të pasuksesshëm për shkak të çmimit. Gjatë kontrollimit ne hasëm se edhe OE tjera nuk janë të gjithë të përgjegjshëm pasi që kanë mungesë të dokumenteve të cilat janë kërkuar në DT.

OE Samire Osmani B.I. nuk e plotëson kriterin e dosjes së tenderit tek kapaciteti teknik dhe / ose profesional që keni kërku:

Kërkesa 3
Kompania duhet të ketënje ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit dhe hapësirave të ndryshme .

Certifikatat e ofruara për punëtorët nuk janë certifikata ndërkombëtare sicështë kërkuar në DT . siq e kemi

cekur edhe më lartëcdo certifikatë ndërkombëtare posedon numër dhe validitet, të cilat mund të verifikohen nëfaqen e lëshuesit të certifikatës.
Poashtu nuk plotëson kriterin tek Anexi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme pasi që i njëjti nuk ka ofruar një deklaratë të tillë për produktin e ofruar e cila është kërkuar në DT të këtij tenderi (Deklaratë nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja QË DESHMON QE DENZIFEKTUESI I TILL ËSHTË EFIKSAS PER ELIMINIMIN E COVID – 19).

OE FAUNA Group SHPK nuk e plotëson kriterin e dosjes të kapacitetit teknik dhe profesional që keni **Kërkesa 3**
Kompania duhet të ketënje ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit dhe hapësirave të ndryshme .

Nuk posedon një ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit të hapësirave të ndryshme siqështë kërkuar në DT. I njëjti ka ofruar certifikata për Auditor të brendshëm për standardet ISO 9001:2015, 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 (per 12 punetore). Eshteper tu habit se si te gjitha këto certifikata jo qe nuk e plotësojnë kushtin qëështë kërkuar në DT por edhe siq janë nuk posedojnë numër. Siq e kemi cekur edhe më lartë se cdoqertifikatë ndërkombëtare posedon numër dhe validitet, të cilat mund të verifikohen në faqen e lëshuesit tëqertifikatës.

AK me rastin e vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së citat neni 1 i LPP-së:

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

AK me këtë ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7.6(v) dhe (vi) citat:

(v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

.

Nga te cekurat me larte janë evidente, te prekshme, dhe kërkojmë nga Paneli Shqyrtues me rastin e shqyrtimit te kësaj ankese tone, konform, lidhur me tenderin: **"Deratizimi, Dezinsektimi, Dezifektimi në Objektet e Komunës së Pejës"** me nr te prok: **635-20-5894-2-2-1** merr kete:
VENDIM
APROVOHET, si e bazuar ankesa e **OE "EKO-DDD" - Ferizaj, lidhur me tenderin** : **"Deratizimi, Dezinsektimi, Dezifektimi në Objektet e Komunës së Pejës"** me nr te prok: **635-20-5894-2-2-1**

ANULOHET, njoftimi per dhënie te kontratës lidhur me tenderin : **"Deratizimi, Dezinsektimi, Dezifektiminë Objektet e Komunës së Pejës"** me nr te prok: **635-20-5894-2-2-1**

Shpresojmë që ju si Panel do të merrni një vendim të drejtë që të mos lejoni që një OE i papërgjegjshëm në ofertën e tij të ketë mundësi të përfitoj nga fondet publike dhe në të njëjtën kohë të udhëzoni Komunën e Pejës që të mos vepron në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, (Neni 1,6,7,28,56,59, 72, te cilët janë vënë për të gjithë OE dhe autoritetet kontraktuese duke mos bërë asnjë përjashtim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kriteret e kerkuara nga AK-ja (per pretendimet qe ka OE ankues):

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa 1 **Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjajëshme në vler prej 100.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.** **Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3vitet e fundit.**	**Dëshmia 1** **Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të shërbimeve.**
Kërkesa 2 **Kompanija duhet të jetë e licencuar për pastrim,Dezinfektim,Dezinsektim, dhe Deratizim, për shkolla,qerdhe,spitale, ambulanta dhe objekte tjera private.**	**Dëshmia 2** **Kopje e licences e leshuar nga Departamenti i Politikave Bujqesore dhe Tregtis për D.D.D**
Kërkesa 3 **Kompanija duhet të ketë 1 ekspert me trajnim nderkombetar për kryerjen e pastrimit dhe denzifektimit të hapsirave të ndryshme.**	**Dëshmia 2** **Certifikat që dëshmon mbi kryerien e trajnimit ndërkombetar.**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Tëpërshkruhetvetëmvlërësimi i ofertëssë OE ankues /ofertave, përtë cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Lista e OE-ve te përgjegjshëm sipas Raportit te vlerësimit:

Radhë	Lënda / grupi: Deratizimi, Dezinsektimi,Dezifektimi në objektete e Komunës së Pejës	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	ECO Vetrok SH.P.K., 810749658	29 000,00
2.	SAMIRE OSMANI B.I., 601544499	31 800,00
3.	FAUNA GROUP SH.P.K., 811431238	43 500,00
4.	Besim A. Zejnullahu B.I., 810668428	49 250,00

OE: ECO Vetrok SH.P.K. është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne ketë rast sipas kriterit për dhënie te kontratës (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet) shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse ka ofruar çmimin me te lire Oferta e këtij OE 29.000.00 €

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: nr.955/20

Pergjigje në pretendimin e parë ankimor

Eksperti i OSHP-së sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se :

Në dosjen e tenderit te kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:

Kerkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjajëshme në vler prej 100.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.

Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3vitet e fundit.

OE i shpërblyer me kontratë nuk e plotëson këtë kriter pasi që në listën e ofruar dhe dëshmitë mbi projektet e realizuara nuk ka asnjë projekt të ngjashëm me titullin e këtij tenderi: Deratizim, dezinsektim dhe dezinfektim të objekteve. Të gjitha dëshmitë e ofruara janë vetëm në lëminë e pastrimit. Asnjë projekt nuk ka të realizuar në deratizim, dezinsektim apo dezinfektim. Nuk është rastësi që për shërbime të DDD duhet të licencohesh fillimisht. Kompania në fjalë është e licencuar për shërbime të DDD (në gusht 2020), por deri tani nuk ka asnjë dëshmi që ka realizuar ndonjë nga këto shërbime (deratizim, dezinfektim apo dezinsektim).

Eksperti i OSHP-së, sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues per kriterin e kërkuar : **Kerkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjajëshme në vler prej 100.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.**

Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3vitet e fundit.

Termi te ngjashme mendoj se duhet te përfshijë referenca ne fushën e Dezinfektimit, dezinsektimit dhe deratizimit e jo te jene te ngjashme shërbimet e pastrimit. Pra, siç pretendon OE ankues, se për shërbime te DDD duhet te kete licence përkëtë fushe. Mendoj se shërbime te ngjashme qe kane te bëjnë me kete fushe janë shërbime te cilat kane te bëjnë me natyrën e eliminimit te mikrobeve, viruseve, por megjithatë kërkesa e AK-se nuk eshte e qarte dhe vendosjen e kritereve sepse natyra e punës është dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi dhe nuk mendoj se është natyre e ngjashme pastrimi, per shkak se rëndësia dhe përgjegjësia eshte me e madhe ne DDD se sa ne pastrime.

Pretendimi ankimor ne kete pike eshte i pjeserishem.

Përgjigje ne pretendimin e dyte ankimor
Në dosjen e tenderit te kapaciteti teknik dhe profesional AK kërkuar:
Kërkesa 3
Kompanija duhet të ketë 1 ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit të hapësirave të ndryshme.
Dëshmia 2
Certifikat që dëshmon mbi kryerien e trajnimit ndërkombetar.

OE i shpërblyer me kontratë ka ofruar një diplomë në gjuhën gjermane të lëshuar në tetor 2012

Der Vetron master weist Xhevdet Latifi

Als qualifizierte Reinigungs – Fachkraftaus.
Ky dokument nuk i plotëson kriteret e DT për këto arsye:

1.Ne baze te këtij neni 13.4. Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze

Dokumenti i ofruar nuk pranohet pasi që i njëjti është në gjuhën gjermane:
2. Nëse përkthehet ky dokument nuk besojmë se i plotëson kërkesat e DT-së pasi i njëjti nuk përmban fare trajnim për dezinfektim, por vetëm për pastrim

3. Ky dokument na bën të dyshojmë pasi që për trajnime lëshohen certifikata, ndërsa në dokument nuk ka shkruar fare certifikatë vetëm ne ballë të këtij dokumenti shënon DIPLOM (duhet të verifikohet nga AK)
4. Çdo certifikate ndërkombëtare posedon numër dhe validitet te cilat mund te verifikohen ne web faqen e lëshuesit te certifikatës (OE nuk e posedon një të tillë).

Eksperti shqyrtues *sqaron se OE i rekomanduar për kontrate ne kriterin e FDT dhe NJK ka kërkuar:*
Te **Kërkesa 3: Kompanija duhet të ketë 1 ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe denzifektimit të hapësirave të ndryshme, kurse te**
Dëshmia 2 : Certifikat që dëshmon mbi kryerien e trajnimit ndërkombetar.

Dokumenti i bashkangjitur ne dosje te OE se rekomanduar DIPLOM, është ne gjuhen gjermane dhe ky dokument nuk është ne përputhshmëri me LPP-ne, konkretisht **paragrafin 4 te nenit 13** qe thotë: ***"Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze".***

Pra, certifikata ne gjuhen gjermane ka kuptim se:..*Xhevdet Latifi* si specialist i kualifikuar i pastrimit. **Pra, kriteri i kërkuar është per kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit te hapësirave te ndryshme.**
Pra, certifikata ne fjale eshte per specialist te kualifikuar te pastrimit, por nuk eshte per dezinfektim!
Sipas certifikatës nuk plotësohet kriteri plotësisht i AK-se, edhe përkundër se gjuha e dokumentit nuk është ne gjuhen zyrtare sic e kërkon LPP-ja, konkretisht neni 13.4 i LPP-së, qe dokumentet duhet te jene ne njërën nga tri gjuhet zyrtare: Shqipe, serbe ose angleze.

Pretendimi ankimor per kete eshte pjeserisht i bazuar.

Përgjigje ne pretendimin e trete ankimor
Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues se: Te anexi 1 ne DT – Specifikimet teknike të detyrueshme është kërkuar: Preparati për dezinfektim Micro- quat classic ose ekuivalent (e cila duhet te posedoj një deklaratë nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja, që dëshmon se dezinfektuesi i tillë është efikas për eliminimin e Covid-19 te OE i shpërblyer me kontratë nuk plotëson këtë kriter pasi që i njëjti nuk ka ofruar një deklaratë të tillë e cila është kërkuar në DT e këtij tenderi (DEKLARAT NGA ECDC, OBSH ose IKSHP-ja QË DESHMON QE DENZIFEKTUESI I TILL ËSHTË EFIKSAS PER ELIMINIMIN E COVID– 19).

OE i shpërblyer me kontratë nuk plotëson këtë kriter pasi i njëjti nuk ka ofruar ndonjë deklaratë të tillë e cila është kërkuar në DT e këtij tenderi (Deklaratë nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja QË DESHMON QE DENZIFEKTUESI I TILL ËSHTË EFIKSAS PER ELIMINIMIN E COVID – 19)

Eksperti i OSHP-së, sqaron se OE i rekomanduar nuk e ploteson Deklaraten nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja, qe dëshmon se Dezinfektuesi eshte efikas per eliminimin e Covid-19.

Kjo deklarate kërkohet ne Pershkrimin e çmimit te dosjes se tenderit, qe AK e ka kërkuar, por OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar kete deklarate nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja, qe e dëshmon se Dezinfektuesi eshte efikas per eliminimin e Covid-19.
Pra, nuk gjindet kjo deklarate ne dosjen e OE te rekomanduar!

Pretendimi ankimor i bazuar.

Përgjigje ne pretendimin e katerte ankimor

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues , se **OE Samire Osmani B.I.** nuk e plotëson kriterin e dosjes së tenderit tek kapaciteti teknik dhe / ose profesional që keni kërku: **Kërkesa 3: Kompania duhet të ketënjë ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit dhe hapësirave të ndryshme .**

Certifikatat e ofruara për punëtorët nuk janë certifikata ndërkombëtare siçështë kërkuar në DT . siç e kemi cekur edhe më lartë çdo certifikatë ndërkombëtare posedon numër dhe validitet, të cilat mund të verifikohen në faqen e lëshuesit të certifikatës.

Eksperti i OSHP-se, sqaron se OE "Samire Osmani" B.I, lidhur me pretendimin e kërkuar ankimor ka te bashkangjitur certifikatat e katër punetoreve : ZylaGashi, Berat Gashi, Kastriot Gashi dhe Arsim Gashi, ku përshkrimi ne kete certifikate eshte: psh.*Zyla Gashi ka ndjekur me sukses trajnimet dhe është certifikuar nga instituti ynë për përdorim dhe kombinim të përgatitjeve për dezinfektimin e hapësirës së jashtme dhe të brendshme.*

Kriteri i kërkuar ne FDT eshte: **Kompania duhet të ketë një ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit dhe hapësirave të ndryshme .**

Pasi qe per këto certifikata AK mund te qartësoj sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së, pasi siç pretendon OE ankues nuk ka numër qe mund te verifikohen certifikatat e tilla. Pra, AK mund ti vërtetoj këto certifikata.

Poashtu nuk plotëson kriterin tek Anexi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme pasi që i njëjti nuk ka ofruar një deklaratë të tillë për produktin e ofruar e cila është kërkuar në DT të këtij tenderi (Deklaratë nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja QË DESHMON QE DENZIFEKTUESI I TILL ËSHTË EFIKSAS PER ELIMINIMIN E COVID – 19).

Poashtu lidhur me kete pretendim ankimor OE ankues pretendon se OE Samire Osmani nuk e ka dëshmuar deklaratën nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja., ne dosjen e OE ankues nuk ka ndonjë deklarate te tille qe dëshmon se e përmbush kërkesën e AK-se. AK eshte përgjegjëse per respektimin e kritereve te kërkuara ne FDT dhe Njoftim per kontrate..

Ne dosjen e OE Samire Osmani gjindet nje udhëzim qe ne ang. Shkruhet Interim Guidance for Environmental cleaning in non health care facilities exsposed to SARS Cov-2, kurse ne përkthim don te thotë: Udhezime te përkohshme per pastrimin e mjedisit ne objektet e kujdesit shëndetësor te ekspozuara ndaj Sars cov-2.

Poashtu eshte bashkangjitur edhe nje Data Sheet – Identifikimi i përzierjes se substancave – ECOLAB, por nuk ka ndonjë dëshmi ashtu sic e ka kërkuar AK ne FDT dhe NJpK.

Pra, nuk gjindet ndonjë dokument qe perputhet me kërkesën e AK-se (citim): (Deklaratë nga ECDC, OBSH ose IKSHP-ja QË DESHMON QE DENZIFEKTUESI I TILL ËSHTË EFIKSAS PER ELIMINIMIN E COVID – 19).

Pra, OE Samire Osmani B.I. nuk e përmban këtë deklarate për produktin siç është kërkuar nga AK te Përshkrimi i Çmimit.

Pretendimi i OE ankues i bazuar.

Përgjigje ne pretendimin e peste ankimor

Lidhur me pretendimin e OE ankues, per OE FAUNA Group SHPK se nuk e plotëson kriterin e dosjes të kapacitetit teknik dhe profesional që keni **Kërkesa 3: Kompania duhet të ketënje ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit dhe hapësirave të ndryshme .**

-Nuk posedon një ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit të hapësirave të ndryshme siq është kërkuar në DT. I njëjti ka ofruar certifikata për Auditor të brendshëm për standardet ISO 9001:2015, 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 (per 12 punetore). Eshte per tu habit se si te gjitha këto certifikata jo qe nuk e plotësojnë kushtin që është kërkuar në DT por edhe siq janë nuk posedojnë numër. Siq e kemi cekur edhe më lartë se cdoqertifikatë ndërkombëtare posedon numër dhe validitet, të cilat mund të verifikohen në faqen e lëshuesit të qertifikatës.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se **OE FAUNA Group SHPK** nuk e plotëson kriterin e dosjes të kapacitetit teknik dhe profesional që keni **Kërkesa 3: Kompania duhet të ketë një ekspert me trajnim ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit dhe hapësirave të ndryshme .**

Eksperti i OSHP-së, sqaron se *OE FAUNA Group SHPK*, ne dosjen e tij ka te bashkangjitur disa certifikata te lëshuara nga M&NL Consulting ne emër te Flon Rudaku, Mehmet Maliqi, Shpend Fejzullahu, Bardhyl Ismajli etj , qe ne certifikate shkruan (citim): **Ka përfunduar me sukses trajnimin per auditor te brendshëm per standardet ISO 9001:2015; 14001:2015 dhe 45001:2018. Certifikatat janë lëshuar me dt.08.11.2019.**

Pra, kërkesa e AK-se është ekspert ndërkombëtar për kryerjen e pastrimit dhe dezinfektimit te hapësirave te ndryshme, gje qe ky kriter i kërkuar i AK-se duhet te kerkohet sepse kerkesa e Ak-se nuk nderlidhet me dokumentin e prezantuar nga OE ofertues..

Pretendimi ankimor i bazuar.

AK te respektoj kriteret e kërkuara sipas FDT dhe Njoftimit per Kontrate sipas nenit 59.4 te LPP-se, por per cdo paqartesi AK mund te qarteson sipas nenit 72 te LPP-se dhe nenin 39 te RrUOPP-së siç i lejon LPP-ja dhe RrUOPP-ja.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelitshqyrtues që te ankesa te aprovohet si e bazuar dhe AK te vendos sipas kritereve te kërkuara ne FDT dhe Njoftim për kontrate.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **Komuna Pejë**
- Panelit Shqyrtues - **OSHP.**
- OE ankues - **OE. "Besim Zejnullahu" B.I**